

UDHËZIM I PËRBASHKËT

PËR RREGULLAT E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE DHE FONDEVE TË NEVOJSHME PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË SEKTORIT TË MBROJTJES SË DËSHMITARËVE DHE BASHKËPUNËTORËVE TË DREJTËSISË.

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës, nenit 4 pika 4 dhe nenit 5 germa “e” të ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, me qëllim administrimin, menaxhimin dhe përdorimin me efektivitet të fondeve

UDHËZOJMË:

I. Dispozita të përgjithshme

“Dëshmitar i drejtësisë”, “Bashkëpunëtor i drejtësisë”, “Persona të afërm”, “Persona të lidhur”, “Persona të mbrojtur” dhe “Gjendje rreziku”, i referohen nenit 2 të ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë”.

II. Dispozita të veçanta

Organet përgjegjëse për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, janë:

a) Sektori për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

b) Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

III. Planifikimi i fondeve buxhetore

1. Sektori për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë në funksion të programit të posaçëm të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, harton projektbuxhetin, i cili pasi miratohet nga drejtori i Luftës Kundër Krimin të Organizuar dhe Mbrojtjes së Dëshmitarëve i paraqitet brenda datës 10 gusht, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

2. Buxheti në dispozicion të këtij sektori është zë i veçantë, në buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe çelet me program financiar, që fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik. Ai detajohet në 4 dhe 2-mujor dhe depozitohet në degën e buxhetit Tiranë për zbatim.

3. Kërkesa për buxhet i referohet nenit 10 të ligjit nr.9205, datë 15.3.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë” dhe programohet në baze të:

- numrit të rasteve (dëshmitarëve të drejtësisë) me masa të posaçme të mbrojtjes me efekte financiare, faktit të shpenzimeve të vitit paraardhës dhe 6-mujorit të vitit ushtrimor;

- nivelit të taksave dhe tarifave për shërbimet ndaj të tretëve për rastet e ndryshimit të identitetit, vendbanimit, shërbimit mjekësor brenda vendit dhe jashtë vendit, rikualifikimit profesional, dhënies së këshillave dhe të ndihmës së specializuar ligjore etj);

- numrit të rasteve që trajtohen me ndihmë financiare, referuar limitit financiar dhe kohës ndërmjet dy punësimeve, numrit të apartamenteve të marra me qira për banim brenda dhe jashtë vendit dhe tarifës mujore të likuidimit të tyre,

- numrit të apartamenteve të marra me qira brenda dhe jashtë vendit për punë profesionale (operative) dhe tarifës mujore të likuidimit të tyre;

- krijimit dhe përmirësimit të infrastrukturës (inventarit të pajisjeve) dhe të materialeve të tjera specifike për punë operative etj.

Në kërkesën për buxhet do të përllogaritet edhe fondi për akomodimin dhe trajtimin financiar të personave të huaj, kjo në bazë të marrëveshjeve sipas reciprocitetit (Sektorit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe shteteve përkatëse).

Pjesë përbërëse e buxhetit të Sektorit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, do të jenë edhe fondet me burim financimi nga sponsorizimet vetëm nga donatorë të huaj.

Detajimi i këtyre fondeve do të bëhet sipas përcaktimit të donatorit. Procedura e çeljes në degën e buxhetit është e njëjtë si për fondet buxhetore.

IV. Niveli i aplikimit të taksave, tarifave dhe ndihmës financiare

1. Niveli i shpenzimeve për rastet e ndryshimit të identitetit, vendbanimit, shërbimit mjekësor brenda dhe jashtë vendit, rikualifikimit profesional, dhënies së këshillave e të ndihmës së specializuar

ligjore etj.) do të jetë ai i përcaktuar në legjislacionin financiar, si ligji për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë, ligji për sistemin e taksave vendore, urdhrave të Ministrit të Rendit Publik, Ministrit të Shëndetësisë, Ministrit të Drejtësisë etj., për aplikimin e tarifave për shërbimet që u ofrohen të tretëve.

2. Limiti i shpenzimeve për ndihmën financiare për “Dëshmitarin e drejtësisë”, për kohën ndërmjet dy punësimeve do t’i referohet, gjendjes financiare përpara përfshirjes në programin e mbrojtjes.

3. Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, miraton rast pas rasti limitin (shumën në lekë) për personat e përcaktuar në këtë ligj, si më poshtë:

a) Për personat që nuk kanë qenë në marrëdhënie pune dhe për të miturit, ndihma financiare nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale në shkallë vendi e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave dhe jo më shumë se 2.5 herë të kësaj page.

b) Për personat e punësuar në institucionet shtetërore apo kompanitë private, limiti minimal do të jetë i barabartë me pagën neto të përfutur muajin e fundit, përpara përfshirjes në programin e mbrojtjes dhe jo më shumë se 1.5 herë të kësaj page.

c) Për personat që përfitojnë pension të pjesshëm, invaliditeti ose pension të plotë pleqërie para përfshirjes në programin e mbrojtjes, bëhet rimbursimi i shumës përkatëse, referuar limitit financiar minimal dhe maksimal të përcaktuar në gërmën “a” të këtij udhëzimi.

Vlera absolute e rimbursimit, si për nivelin minimal apo atë maksimal, evidentohet dhe miratohet në marrëveshjen që nënshkruhet nga personi i përfshirë në programin e mbrojtjes dhe nga përfaqësuesi i Sektorit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

ç) Në rastet kur, përveç dëshmitarit të drejtësisë, përfshihen në programin e posaçëm të mbrojtjes edhe personat e afërm, ku sipas përcaktimeve të nenit 16 të Kodit të Procedurës Penale si rregull, banojnë ose bashkëjetojnë në mënyrë të qëndrueshme me të, limiti i ndihmës financiare për çdo person të marrë në mbrojtje, do të jetë i barabartë me nivelin e pagës minimale në shkallë vendi të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Për raste të veçanta me propozim të Komisionit dhe me miratim të Ministrit të Rendit Publik, niveli i ndihmës financiare për personat e përcaktuar në gërmën “a” dhe “c” të pikës tre të këtij udhëzimi do të jetë 3 herë më i madh se niveli i pagës minimale në shkallë vendi dhe 3 herë të pagës neto të muajit të fundit për personat e punësuar në institucionet shtetërore apo kompanitë private.

Propozimi për rritjen në vlerë të ndihmës financiare, duhet të jetë i argumentuar dhe të parashikojë efektet që priten nga kjo rritje.

Niveli i ndihmës (limiti) financiare i përcaktuar në këtë udhëzim zbatohet edhe për personat e afërm apo të lidhur me bashkëpunëtorin e drejtësisë.

4. Për dëshmitarët e drejtësisë, personat e afërm dhe personat e lidhur që do të akomodohen jashtë vendit, Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, miraton limitin financiar në valutë, (USD, euro, etj.) sipas monedhës së vendit përkatës dhe nuk mund të jetë më i vogël se minimumi jetik në këto vende.

Ndërsa për rastet e marrjes (përfshirjes) në një program mbrojtjeje, të dëshmitarit dhe të personave të afërm (neni 16 i Kodit të Procedurës Penale) niveli i ndihmës (limiti) financiare për çdo person do të jetë sa paga minimale e vendit (shtetit) ku janë akomoduar dëshmitarët e drejtësisë.

5. Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë miraton tarifën për marrjen me qira të apartamenteve ose banesave për dëshmitarët e drejtësisë dhe personat e afërm të tyre. Në përcaktimin e tarifës Komisioni i referohet sipërfaqes në m², pajisjeve që duhet të posedohen në këto ambiente, tarifave që publikohen në mediane dhe shkruar nga axhensitë imobilare dhe përshtatshmërisë së tyre në funksion të sigurisë etj. Mbi këtë bazë Komisioni miraton tarifën mujore apo vjetore.

Likuidimi i shpenzimeve për marrjen me qira të apartamenteve apo banesave përballohet nga buxheti i vënë në dispozicion të Sektorit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë. Kurse shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm do të likuidohen sipas faturave që lëshohen nga institucionet përkatëse dhe do të përballohen nga niveli i ndihmës financiare që përfiton personi i marrë në mbrojtje.

Një gjë e tillë fiksohet në marrëveshjen që nënshkruhet ndërmjet personit të marrë në mbrojtje dhe përfaqësuesit të Sektorit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të

Drejtësisë.

Për rastet e zbatimit të masave të përkohshme të mbrojtjes, niveli i taksave, tarifave dhe ndihmës financiare për personat e mbrojtur, miratohet nga kryetari i Komisionit për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

V. Procedura e zbatimit të buxhetit

1. Çelja e planit të buxhetit për fondin e konsoliduar dhe atë nga të ardhurat dhe sponsorizimet (vetëm me donatorë të huaj) bëhen në nivel titulli (034) kapitulli (1; 5 dhe 6) dhe artikulli dhe përfaqësojnë limitin maksimal të lejuar për t'u zbatuar.

2. Raportimi mujor i shpenzimeve faktike nga dega e thesarit, bëhet sipas klasifikimit ekonomik, funksional dhe organizativ dhe sipas procedurave të thesarit. Klasifikimi ekonomik i shpenzimeve dhe i të ardhurave është ai i përcaktuar në manualin e klasifikimit ekonomik buxhetor të miratuar nga Ministri i Financave.

3. Dega e thesarit në bazë të planit të dërguar nga dega e buxhetit, miraton dokumentacionin financiar (çek dhe urdhërpagesë etj.) për kryerjen e shpenzimeve. Në këtë dokumentacion përveç shënimeve standarde evidentohet vetëm përshkrimi i veprimit "Shpenzime sekrete të Sektorit për Mbrojtjen Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë".

Miratimi i dokumentacionit në degën e thesarit bëhet nga një punonjës i autorizuar për këtë qëllim dhe nga kryetari i degës së thesarit, Tiranë.

4. Mënyra e rakordimit, evidentimit në librat e kontabilitetit, menaxhimit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve do të jetë konform kërkesave të ligjit organik "Të Buxhetit të Shtetit", udhëzimit të Ministrit të Financave "Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit", ligjit "Për kontabilitetin" dhe nenit 14 të urdhrat të Ministrit të Rendit Publik nr.2087, datë 15.3.2005 "Për funksionimin dhe organizimin e Sektorit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë".

VI. Administrimi i pasurisë

1. Administrimi i pasurisë do të kryhet sipas kërkesave të ligjit për kontabilitetin dhe planin unik kontabël të miratuar nr.248, datë 10.3.1998 të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Struktura dhe klasifikimi kontabël analitik i pasurisë do të jetë konform planit unik kontabël.

3. Për administrimin e pajisjeve speciale (që ndodhen në apartamentet e marra me qira), krahas evidentimit në llogari, të plotësohen kartelat (skeda), ku të evidentohen karakteristikat teknike dhe të dhënat vlerore, si vlera kontabël bruto, shuma e amortizimit, vlera kontabël neto dhe vlera e riparimit të pajisjes.

4. Administrimi i pasurisë duhet të sigurojë:

- Ruajtjen dhe administrimin e pasurisë në përdorim;
- Regjistrimin kronologjik të të gjitha dokumenteve në librat e kontabilitetit;
- Ruajtjen e të dhënave dhe disponimin e tyre në çdo kohë;
- Kontrollin e plotë të gjendjes sasiore e cilësore të pasurisë dhe lëvizjet e saj;
- Përgatitjen e dokumenteve përmbledhëse dhe nxjerrjen e të dhënave të nevojshme për hartimin e programit material e financiar dhe kontrollin e realizimit të tij.

5. Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, sipas rastit miraton edhe mënyrën e administrimit të pasurisë së paluajtshme dhe të luajtshme të personave të marrë në mbrojtje. Një gjë e tillë evidentohet në marrëveshjen që nënshkruhet me personin e marrë në mbrojtje.

VII. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Sektori i Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe Komisioni për Vlerësimin e Masave të Posaçme të Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë.

VIII. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.4.2005.